



Hepatiti B,
Hepatiti C
dhe HIV-i

Testohuni ndërkohë që jeni në burg

Hepatiti C është...



një virus që gjendet në gjak dhe shpërndahet nëpërmjet kontaktit gjak me gjak, për shembull nëpërmjet shkëmbimit të gjilpërave të pasterilizuara. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet procedurave të pasterilizuara mjekësore dhe atyre të tatuazhit.


Shkëmbimi i gjilpërave dhe mjeteve të tjera me të cilat merret drogë, si për shembull lugët ose fletët metalike, mundet që sërish të paraqesin rrezik për transmetimin e viruseve të lindur në gjak.

Njerëzit e lindur me hepatit C mund të mos kenë shenja megjithatë nëse nuk mjekohen virusi mund të shkaktojë dëmtim të rëndë të mëlçisë përfshi kancerin.



Testohuni ndërkohë që jeni në burg!

Hepatiti B është...



Një virus që gjendet në gjak dhe në lëngjet e trupit.

Ai transmetohet në të njëjtën mënyrë sikurse hepatiti C por mundet të transmetohet edhe nëpërmjet seksit të pambrojtur ose nga nëna tek bebjë gjatë lindjes.

Ekzistojnë vakcina (injeksione) për të parandaluar infektimin.

Rekomandohet fuqimisht që t'i bëni vaksinat gjatë qëndrimit në burg - thjesht pyesni personelin mjekësor të burgut.



Vaksinohuni kundër hepatitit B ndërkohë që jeni në burg!

HIV-i është...



një virus që gjendet në gjak dhe në lëngjet e tjera të trupit si sperma.

HIV-i ndikon tek sistemi imunitar. Virusi mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit të gjakut me gjak sikurse edhe hepatiti por mund të transmetohet edhe nëpërmjet seksit të pambrojtur.

Ekziston trajtim për HIV-in dhe ai mund të jepet në burg. Përdorimi i prezervativëve ju ndihmon të mbroheni ndaj HIV-it.



Testohuni për HIV-in ndërkohë që jeni në burg!

Përdoreni burgun si një mundësi për të marrë më shumë informacion... dhe për t'u testuar!

Kjo fletëpalosje përshkruan 3 viruse që lindin në gjak: Hepatitin B, Hepatitin C (verdhëza e tipit B dhe C) dhe HIV-in. Këto janë sëmundje potenciale të rënda që mund të mos japin asnjë shenjë, ndaj njerëzit mund të mos e kuptojnë se janë të infektuar.

Është e rëndësishme të kuptoni se si transmetohen këto sëmundje në mënyrë që të shmangni rrezikun e infektimit. Nëse mendoni se jeni ekspozuar ndaj një rreziku atëherë mund të testoheni dhe trajtoheni për viruse që lindin në gjak ndërkohë që jeni në burg.

Transmetimi i viruse që lindin në gjak mund të parandalohet:

- Mos i shkëmbeni kurrë gjilpërat ose pajisjet e marrjes së drogës për asnjë lloj përdorimi të drogës.
- Sigurohuni që pasjet e tatuazhit ose të shpimit të trupit të jenë sterile.
- Përdorni gjithnjë prezervativë për të parandaluar transmetimin seksual.
- Hepatiti B, C dhe HIV-i mund të mjekohen. Pas kontrollit, mjekimi mund të fillohet ndërkohë që jeni në burg. Nëse mendoni se keni qenë në rrezik ndaj infektimit nga hepatiti B dhe C e doni të testoheni (një test i thjeshtë gjaku) ose doni thjesht më shumë informacion, flisni me infermieret dhe doktorët në departamentin e kujdesit shëndetësor të burgut.
- Mos harroni të pyesni për vaksinat e hepatitit B!



Iechyd Cyhoeddus
Cymru
Public Health
Wales

Produced by Public Health Wales in conjunction with G4S and HM Prison Service. Further copies can be obtained from www.publichealthwales.org/prison-health

